



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

Kontrolli i Lartë i Shtetit

# **RAPORT MONITORIMI PËR STRATEGJINË E MENAXHIMIT TË RISKUT PËR KLSH 2022**

## Hyrje

Strategjia e Menaxhimit të Riskut (e rishikuar), për Kontrollin e Lartë të Shtetit reflekton kërkesat e ISSAI 9130 “Udhëzues për standardet e kontrollit të brendshëm për sektorin publik -Informacion i zgjeruar për menaxhimin e riskut institucional”, ligjin nr.10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar, si dhe i referohet objektivave të vendosura në Strategjinë e Zhvillimit të KLSH 2018-2022.

Në Strategjinë e Menaxhimit të Riskut të rishikuar, KLSH ka identifikuar risqet kryesore, të jashtme dhe të brendshme, risqet e menaxhimit institucional dhe risqe të punës audituese, kriteret për përcaktimin e risqeve madhore, mekanizmat e riskut si dhe kriteret për matjen e riskut, në përputhje me politikat e KLSH.

Strategjia e Menaxhimit të Riskut është e bazuar në një program të kontrollit të brendshëm dhe menaxhimit të riskut të nevojshëm për të maksimizuar burimet në dispozicion me qëllim përmbushjen e objektivave dhe të maksimizojë vlerën e rezultateve të punës audituese duke minimizuar risqet e brendshme ashtu dhe ato të jashtme.

Në këtë kuadër, menaxhimi i riskut përmban identifikimin, vlerësimin dhe kontrollin mbi ato ngjarje apo situata të mundshme, që kanë efekt të dëmshëm për përmbushjen e objektivave të njësisë publike, dhe kryhet për të dhënë siguri të arsyeshme se këta objektiva do të realizohen. Risku matet sipas efektit të tij dhe shkallës së probabilitetit të ngjarjes. Menaxhimi i riskut konsiderohet dhe vlerësohet si përgjegjësi e çdo punonjësi në KLSH, dhe përfshihet në të gjitha sistemet e menaxhimit dhe planifikimit të veprimtarisë institucionale

Monitorimi paraqet vlerësimin e riskut me të cilën përballat KLSH si institucion auditues dhe vlerësimin e riskut me të cilin përballen departamentet e veçanta të auditimit. Veprimtaria e audituesit të jashtëm publik realizohet në kushte të një ndryshimi të vazhdueshëm të mjedisit të jashtëm, faktor kryesor ndryshimi i të cilit janë vetë audituesit e jashtëm publik. Monitorimi periodik vjetor dhe përditësimi i perceptimit për riskun është vlerësuar edhe një domosdoshmëri për ecuri të suksesshme në arritjen e objektivave dhe përmbushjen e misionit të KLSH.

Nëpërmjet analizës dhe kryerjes së kontrolleve që synojnë minimizimin e riskut, kryhet çdo vit Monitorimi i SMR, nëpërmjet të cilit realizohet përditësimi i Regjistrit të Riskut, i cili përmban risqet e veprimtarisë audituese (politik, ekonomik, social, teknologjik, ligjor/rregullator dhe ambiental), risqet që lidhen me fushat e vlerësuara me risk më të lartë për auditimet e KLSH, si dhe risqe identifikuar sipas departamenteve të auditimit. Pas përshkrimit të riskut është vlerësuar niveli i tij sipas klasave para dhe pas kontrollit, si dhe nevojat për kontrole të mëtejshme, duke përfshirë veprimet për të adresuar boshllëqet, zotëruesi i riskut dhe ndryshimet në risk nga detyra e fundit

Raporti i Monitorimit të Strategjisë së Riskut përfshin: Analizën e situatës aktuale dhe progresit të bërë krahasuar më periudhën e mëparshme të monitoruara; vlerësimin nëse po veprohet në linjë dhe drejt objektivave të caktuar; identifikimi i problemeve lidhur me menaxhimin e riskut të tilla si: identifikimin e risqeve të reja dhe vlerësimin e tyre, rivlerësimin e risqeve ekzistuese; si dhe përcaktimin e veprimeve të mëtejshme bazuar në eksperiencën e mëparshme dhe studimin për periudhat e ardhme, të cilat gjejnë pasqyrim në përditësimin e

Regjistrin të Riskut.

Monitorimi i Strategjisë synon nxitjen e zhvillimit duke u bazuar në rishikime të rregullta dhe procese të përditësimit të vlerësimeve të risqeve në varësi të ndryshimeve që paraqet ambientiku ushtron veprimtarinë e vet KLSH, ku një rol të rëndësishëm luan ekipi i menaxhimit të riskut, duke bashkëpunuar dhe bashkërenduar veprimtarinë me drejtuesit e strukturave përbërëse të KLSH. Drejtorët e Departamenteve dhe Drejtorive respektive janë pjesëmarrës në të gjithë procesin e identifikimit, vlerësimit dhe monitorimit të riskut.

## **Rezultatet e Monitorimit**

Monitorimi është kryer si një proces periodik, i rregullt dhe sistematik dhe përfshin periudhën ushtrimore Janar-Dhjetor 2022. Anëtarët e Ekipit të Menaxhimit të Riskut, në funksion të implementimit të strategjisë kanë bashkëpunuar dhe bashkërenduar veprimtarinë e tyre me Drejtorët e Departamenteve dhe Drejtorive respektive në funksion të përmbushjes së përgjegjësiave menaxheriale në të gjithë procesin e identifikimit, vlerësimit, monitorimit të riskut me qëllim kryesor përmbushjen e objektivave të Departamentit /Drejtorisë si dhe të objektivave institucionale.

Në nivel institucional, menaxhimi i riskut konsiston në ambientin e kontrollit, vendosjen e objektivave, identifikimin e risqeve dhe vlerësimin e tyre, kontrollin, informimin dhe komunikimin si dhe monitorimin.

Evidentimi i risqeve dhe përditësimi i tyre është kryer duke përdorur analizën SWOT, ku në fuqitë (**Strength**) cilësohen mandati kushtetues, pavarësia institucionale, vizioni, strategjia, kuadri rregullativ, aksesit online, vënia e etikes si vlerë themelore etj.; në dobësitë (**Weakness**) përfshihen vështirësitë në zbatimin e plotë të Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit (ISSAI-ve), në kryerjen e auditimeve financiare dhe dhënin e një opinioni profesional për pasqyrat financiare, formulimi dhe afati i zbatimit të rekomandimeve, ngarkesat në kuadrin rregullator të auditimeve dhe vështirësitë në zbatimin e tyre praktik, mungesa e thellimit në qasjen në bazë risku, mungësi në funksionimin e të gjitha hallkave të kontrollit të cilësisë së auditimit, mungesa e qartësisë dhe koincizitetit në raportimin e auditimit, përqendrimi i trajnimeve kryesisht në burimet e brendshme etj.; mundësitë (**Opportunities**) të cilat konsistojnë në mbështetjen e partnerëve rajonal e më gjerë, promovimi i stafit auditues, rritja e frymës bashkëpunuese në grup, aktivizimi i ekspertëve të jashtëm, rritja e nivelit profesional nëpërmjet trajnimeve nga institucione homologe të përparuara të fushës etj.; ndërsa kërcënimet (**Threats**) kanë të bëjnë me perceptim dhe nganjëherë interpretim jo të drejtë të punës së KLSH nga subjektet e auditimit, palët e interesit, opinioni publik etj.; shkalla e pranimin dhe e zbatimit të rekomandimeve të KLSH; përfshirja e të gjitha institucioneve publike (enteve rregullatorë etj.,) nën auditim, burime financiare dhe njerëzore të pamjaftueshme për të mbuluar me auditim të gjitha entet publike dhe në një kohë optimale etj.

Objektivat e strategjisë së menaxhimit të rrezikut të Kontrollit të Lartë të Shtetit janë:

- Rritja e ndërgjegjësimit për nevojën për menaxhimin e riskut;
- Minimizimi i humbjeve, vjedhjeve, shkatërrimit dhe dëmtimit dhe ulja e kostove duke maksimizuar burimet;

- Informimi i politikave dhe vendimmarrjes duke identifikuar risqet dhe ndikimin e tyre të mundshëm;

Përmbushja e qëllimit dhe objektivave të Strategjisë së Menaxhimit të Riskut realizohet nëpërmjet:

- Vendorsjes së roleve, përgjegjësi dhe linjave të raportimit brenda KLSH për menaxhimin e riskut;
- Komunikim efektiv me dhe përfshirjen aktive të të gjithë stafit të çdo niveli, të udhëhequr nga drejtuesit;
- Monitorimi i progresit të SMR dhe rishikimin e procesit të menaxhimit të rrezikut në vazhdimësi.

✓ Në përmbushje të Urdhrit të Kryetarit të KLSH nr. 26, datë 08.02.2020, si dhe në zbatim të Qëllimeve Prioritare të Strategjisë së Zhvillimit Institucional për periudhën 2018-2022, miratuar me Vendim të Kryetarit të KLSH nr. 229, datë 31.12.2017, të Strategjisë së Menaxhimit të Riskut, miratuar me Vendim të Kryetarit nr. 250 datë 31.12.2018, si dhe Referuar procesit të implementimit dhe monitorimit të strategjisë **është përditësuar Regjistri i Riskut i përbërë nga Matrica e Risqeve Institucionale:** Politike/ Ekonomike/ Sociale/ Teknologjike/ Ligjore/ Rregullatore. Matricat përmbajnë të dhëna analitike çdo risk duke përshkruar riskun , përcaktimin e nivelit të riskut para dhe pas kontrollit cilat janë kontrollet ekzistuese nivelet e vlerësuar për risqet e kontroleve ekzistuese për çdo risk është përcaktuar në se ka nevoja për kontrole të mëtejshme masat që do të ndërmerren për adresimin e boshllëqeve strukturën zotëruese të çdo risku dhe ndryshim e riskut nga statusi i fundit.

✓ Një nga drejtimet e Menaxhimit të riskut është në funksion të **ruajtjes së aseteve të KLSH**, duke vendosur një sistem kontrolli efektiv për të garantuar siguri të arsyeshme për mbrojtjen dhe parandalimin nga abuzimi dhe shpërdorimi i tyre. Për këtë qëllim edhe gjatë vitit 2022, janë marrë masat e nevojshme për dokumentimin, mbrojtjen, qarkullimin e aktiveve, ruajtjen e tyre nga dëmtimi dhe keqpërdorimi, si dhe përdorimin e tyre në përputhje me qëllimin për të cilat janë alokuar. Janë zbatuar në çdo rast kërkesat e parashikuara në Urdhrin nr. 137, datë 08.10.2018 ”Mbi respektimin e afateve kohore për dorëzimin e aktiveve nga punonjësit e KLSH-se në rast largimi nga puna”, në të cilin janë përcaktuar procedurat e detyrueshme dhe afatet për dorëzimin e aktiveve që këta punonjës kanë patur në përdorim.

KLSH, me synim përdorimin me efektivitet, eficiencë dhe ekonomikitet të aseteve në përdorim ka vijuar dhe është kujdesur për:

-Mbrojtjen fizike kundër vjedhjes, vandalizmit, dëmtimeve natyrore, nëpërmjet instalimit të drynave të sigurisë, sistemit të mbrojtjes kundër zjarrit alarmet për parandalimin e zjarrit, kontrollet e inventarëve dhe siguracionet etj.;

-Funksionimi i sistemit dhe procedurave për zëvendësimin e aktiveve të qëndrueshme. Ndjekja dhe monitorimi i jetëgjatësisë standarde të aktiveve sidomos të pajisjeve kompjuterike dhe automjeteve, duke vlerësuar veçmas dobishmërinë dhe jetëgjatësinë e përdorimit të çdo aktivi në konsideratë të normave ligjore të amortizimit, për të shmangur cenimin e vijimësisë së punës nga mosfunksionimi i papritur i aktivitetit;

- Riparim i menjëhershëm i dëmeve dhe shërbime të rregullta mirëmbajtjeje, bazuar në një shqyrtim dhe hartim të një plani mirëmbajtja të aktiveve nga Drejtoria e Shërbimeve dhe IT.

- Shërbime të rregullta mirëmbajtjeje për minimizimin e avarive të mundshme, si dhe për t'u siguruar se pajisjet punojnë me kapacitetet e nevojshme;
- Kryerja e mirëmbajtjes së planifikuar të Aktivitetit të qëndrueshëm të trupëzuara dhe aktiveve të tjera në përdorim, duke siguruar një mbikëqyrje të vazhdueshme, për t'i orientuar shpenzimet drejt parandalimit dhe shmangien e shpenzimeve për kryerjen e riparimeve;
- Trajnimi i punonjësve për përdorimin dhe mbrojtjen e aktiveve, kryesisht sistemeve dhe softeve informatike IT, si dhe tërheqjen e vëmendjes për mirë përdorimin e tyre në vijimësi;

Veç sa më sipër, për përdorimin me efektivitet të aktiveve dhe mbrojtjen nga keqpërdorimi në zbatim të Urdhrit nr. 161, datë 15.11.2018 “Mbi marrjen e masave për miradministrimin nëpërmjet procesit të etikimit/kodimit dhe vendosjes së numrit serial të aktiveve të furnizuara të pajisjeve elektronike dhe kompjuterike në funksion të minimizimit të riskut të keqpërdorimit abuzimit dhe mbrojtjes së tyre” nuk ka përfunduar ende procesi i rifreskimit të kodeve pas përfundimit të procesit të inventarizimit.

- ✓ Në lidhje me hartimin e Projekt Buxhetit të aftë për të përballuar nevojat financiare të KLSH për ushtrimin normal të veprimtarisë audituese, janë përpiluar kërkesat buxhetore në kohë dhe të argumentuara duke mbajtur nën kontroll limitet buxhetore. Sipas rastit janë paraqitur edhe kërkesat për rialokime duke siguruar në çdo kohë përmbushjen e detyrimeve kontraktuale dhe fiskale por dhe mbështetjen e në vijimësi të aktivitetit auditues.
- ✓ Janë ndjekur procedurat e prokurimit sipas parashikimeve të regjistrimit të miratuar të prokurimeve me një realizim të investimeve me financim të brendshëm në masën 87%.
- ✓ Në kuadër të rritjes së transparencës, ka vijuar rregullisht publikimi i rezultateve të auditimit, trajtimi me korrektesë dhe përgjegjshmëri i letrave të popullit, botimet dhe rritja e prezencës së KLSH në media. Brenda vitit 2022, janë publikuar 179 raporte auditimi dhe administruar 428 ankesa dhe kërkesa për informacion nga qytetarët dhe palët e ndryshme të interesit.
- ✓ Në lidhje me menaxhimin e burimeve njerëzore, ka vijuar procesi i rekrutimit për plotësimin e organikës së miratuar. Janë kryer proceset e vlerësimit të performancës së punonjësve për 6-mujor në përputhje me ligjin e nëpunësit civil. Sa i takon strukturës organizative , gjatë vitit 2022 janë bërë ndryshimet përkatëse në funksion të organizimit më të drejtë të linjës hierarkike të raportimit, mbikëqyrjes në funksion të kontrollit të cilësisë por dhe të krijimit të ekspertizave të fushave të caktuara. Në këtë kuadër është riorganizuar Drejtoria e Metodologjisë dhe Zhvillimit Profesional në Departamentin e Metodologjisë, Planifikimit Strategjik dhe Zhvillimit në mbështetje të një planifikimi dhe përshtatjen dinamike të kuadrit metodologjik.
- ✓ Sa i takon përditësimit dhe plotësimit të dokumenteve strategjik, gjatë vitit 2022 u realizua hartimi i Strategjisë së Komunikimit 2022-2025 me mbështetjen e SIGMA si dhe dokumenti i Strategjisë së Zhvillimit Institucional 2023-2027 me mbështetjen e IDI dhe pjesëmarrjen e gjerë të menaxhimit dhe audituesve.
- ✓ Auditimet e teknologjisë së informacionit, janë mbështetur plotësisht në metodologjitë e njohura dhe miratuara të auditimit TI, si dhe audituesit kanë pasuruar njohuritë e tyre në këtë fushë nëpërmjet angazhimeve në auditime pilot me institucione homologe si ZKA Kosovë në fushën e ujësjellësve, auditim i cili pritet të finalizohet brenda 6 muajve të parë të 2023.

- ✓ Në lidhje me auditimet e kryera nga Departamenti i Auditimit të Institucioneve Qendrore, janë reflektuar në programet e auditimit kërkesat që burojnë nga Standardet Ndërkombëtare të Auditimit, në përputhje me llojin e auditimit, me risqet e identifikuar gjatë fazës së planifikimit apo buxhetin e subjektit të audituar. Rekomandimet për përmirësimin e gjendjes janë adresuar tek autoritetet përgjegjëse dhe në çdo rast është ndjekur zbatueshmëria e tyre në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi. Rezultatet e këtyre auditimeve janë reflektuar në Raportin e Zbatimit të Buxhetit të Shtetit për vitin 2021, si dhe në Raportin e Aktivitetit të KLSH-së për vitin 2022.
- ✓ Në lidhje me auditimet e kryera nga Departamenti i Auditimit të Shoqërive Publike dhe Investimeve të Huaja, përgjatë hartimit të programeve të auditimit janë mbajtur në konsideratë ndër të tjera historiku i borxhit si dhe standardet në fushën e raportimit financiar. Rekomandimet për përmirësimin e gjendjes janë adresuar tek autoritetet përgjegjëse dhe në çdo rast është ndjekur zbatueshmëria e tyre në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi. Rezultatet e këtyre auditimeve janë reflektuar në Raportin e Ekzekutimit të Buxhetit të Shtetit për vitin 2021, si dhe në Raportin e Aktivitetit të KLSH-së për vitin 2022.
- ✓ Në lidhje me auditimet e kryera nga Departamenti i Auditimit të Performancës, në funksion të përdorimit me ekonomicitet, efikasitet dhe efektivitetet e fondeve dhe pasurisë publike, janë mbuluar me auditim 6 nga 10 fushat kryesore të diktuar nga Kuadri i Vetëvlerësimit të INTOSAI-t si dhe janë lënë rekomandime për përmirësimin e gjendjes. Audituesit në vijimësi janë bërë pjesë e auditimeve paralele me SAI-e homologe si dhe kanë kryer trajnime në fusha me ndjeshmëri të lartë publike. Nga ky departament është realizuar dhe Udhëzuesi i përcaktimit të fushave me risk në financat publike. Rezultatet e aktivitetit të këtij departamenti janë reflektuar në analizën vjetore të departamentit si edhe në Raportin e Aktivitetit të KLSH-së për vitin 2022.
- ✓ Në lidhje me auditimet e kryera nga Departamenti i Auditimit të Njësive të Vetëqeverisjes Vendore, janë reflektuar në programet e auditimit të gjithë drejtimit që adresojnë boshllëqet e identifikuar. Rekomandimet për përmirësimin e gjendjes janë adresuar tek autoritetet përgjegjëse dhe në çdo rast është ndjekur zbatueshmëria e tyre në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi. Audituesit janë trajnuar në vijimësi, në raport me nevojat e identifikuar. Rezultatet e sa më sipër janë reflektuar në analizën vjetore përkatëse si dhe në Raportin e Aktivitetit të KLSH-së për vitin 2022.
- ✓ Në lidhje me auditimet e kryera nga Departamenti i Auditimit të Aseteve dhe Mjedisit, janë reflektuar në programet e auditimit të gjithë drejtimit e identifikuar me risk në regjistrin e riskut por dhe fazën e planifikimit të çdo auditimi si dhe janë zbatuar me korrektësi pikat e programit. Sa më sipër paraqitur edhe në analizën vjetore të departamentit por edhe në Raportin e Performancës së aktivitetit të KLSH-së për vitin 2022.
- ✓ Në lidhje me aktivitetin e Departamentit të Auditimit të Buxhetit të Shtetit, janë kryer trajnime të vazhdueshme në përputhje me nevojat e identifikuar të stafit auditues; programet e auditimit janë hartuar duke mbajtur në konsideratë gjithë drejtimit që adresojnë boshllëqet. Rezultatet e këtyre auditimeve por edhe e aktivitetit në tërësi të departamentit, janë bërë pjesë e Raportit të Zbatimit të Buxhetit paraqitur në Komisionin për Ekonominë dhe Financat në tetor 2022, Raportit të Performancës së aktivitetit për vitin 2022 si dhe të analizës vjetore të departamentit të zhvilluar në shkurt 2023.